



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4462 prot.



Fushë-Arrëz, më 27.11.2024

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, më 27.11.2024, ora 10:00, në Sallën e Mbledhjeve të Këshillit Bashkiak pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Në mbledhje marrin pjesë: Kryetari i Bashkisë, z.Hil Curri;

Kryetari i Këshillit Bashkiak, z.Nikolin Bardhoku;

Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak, znj.Lezina Ceca;

Zëvendëskryetar i Këshillit Bashkiak, z.Bardhok Qafa si dhe Këshilltarët:

Tereze Dema; Valentina Lleshaj; Besjana Marku; Franc Doda; Valentin Doçi; Vjollca Tabakaj. (9 këshilltarë nga 15 gjithsej)

Në takim marrin pjesë: Përgjegjësja e Çështjeve Sociale, zj. Finete Arifaj;

Elvin Hoxha, qytetar.

Mbledhja kryesohet dhe hapet nga Kryetari i Këshillit Bashkiak, z.Nikolin Bardhoku:

Përshëndetje të gjithëve, në vijim të Njoftimit të datës 21.11.2024 zhvillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak. Verifikojmë pjesëmarrjen e cila plotëson kushtet për zhvillimin e mbledhjes mbasi në sallë janë present 50% +1, presim edhe të tjera. Parashtrohet rendi i ditës:

1. Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Totor 2024.
2. Shqyrtimi i projektvendimit për ristrukturimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Fushë-Arrëz
3. Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.
4. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve,etj.
5. Të ndryshme.

Miratohet rendi i ditës me shumicë votash:

9 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 1. e rendit të ditës: Miratimi i projektvendimit për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6 % për muajin Tetor 2024. Atëherë të referojë zyra dhe komisioni përkatës.

Fitneta Arifaj, Përgjegjëse e Çështjeve Sociale: Siç kemi rënë dakord edhe me Komisionin e Mirëqenjes Sociale, do të kemi një ndryshim vëtëm te Bashkia Qendër, ku kemi vendosur të largojmë Rexhep Beqir Hasani, i cili do të riaplikojë te ndihma ekonomike, gjithashtu nuk është në kushtet e plotësuara për të qenë në skemën e 6%. Është larguar përsye të mungesës fondit. Komisioni ka vendosë të përfshijë në këtë skemë Hase Selman Selmani, është e ndarë nga djali, jeton vetëm dhe plotëson kushtet për të përfituar nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike 6% për muajin Tetor 2024.

Vjollca Tabakaj, këshilltare: shtron pyjetë për Marte Mark Malaj nga Iballja, pse ka dalë nga sistemi?

Fitneta Arifaj, Përgjegjëse Çështjeve Sociale: Është e punësuar, nuk është me siguracion por është e punësuar. Përpas kësaj ajo ka mosdekclarim page nga kompania ku është e punësuar.

Vjollea Tabakaj, këshilltare: Pse ka dalë nga sistemi? Ajo është nënë e vetme duke rrith fëmijë.

Fitneta Arifaj, Përgjegjësja e Çështjeve Sociale: Edhe pse je në punë mund të aplikosh në skemën e ndihmës ekonomike dhe nga këto të ardhura që mund të marrësh nga rruga apo të ardhura të tjera që ke, del nga skema për pikë të pamjaftueshme.

Franc Doda, këshilltar: Ka një rregull që një herë në tre muaj ne duhet të rifreskojmë listën e përfituesve dhe kështu na jepet mundësia të ndihmojmë të tjerë. Duhen aplikime.

Bardhok Qafa, këshilltar: Kemi persona që janë shumë gjatë që përfitojnë nga kjo skemë e ndihmës të cilët duhen hequr dhe të zëvendësohen me të tjerë me nevoja më të shumta.

Fitneta Arifaj, Përgjegjësja e Çështjeve Sociale:

Nëse i heqim ato, fondi mbetet pa u përdorur kur njerëzit kanë nevojë.

Nikolin Bardhoku, Kryetari i Këshillit Bashkiak: Duhet të rishikohet kjo gjë, ne jemi vend i vogël dhe njojhim nëri-tjetrin. Ka person që është te 6%, vërtet është i vetëm, ka pensionin, ka të gjithë të punësuar që e mbështesin dhe pi raki gjithë ditën e më pas thotë jam I sëmurë. Ne nuk mund të bëjmë sikur nuk i shohim gjérat, kjo nuk shkon. Të shpërblehet personi me 6% për të pi raki, kjo nuk duhet të ndodhë. Vërtetë Hasa është e stëmurrë dhe me probleme se e njoh. Të rifreskojen personat sepse mund të ketë prej atyre që kanë nevoja më shumë se këta që janë në listat. Jemi në fund të vitit 2024, me fillimin e Vitit të Ri të bëhen riaplikime, të futen të gjithë, edhe këto që kanë qënë te 6% të riaplikojnë. Duhet të shhangim edhe paragjykimet e opinionit se dikush mund të ketë përfituar sepse ka një person të afërt që punon në bashki dhe ka ndërhyrë. Ju zyra përkatëse që jeni të lidhur me drejtoren përkatëse në Shkodër, duhet të sqaroni rast pas rasti arsyet e përfitimit dhe mospërfitimit të ndihmës.

Kush është dakord t'a kalojmë projektin e Zyrës së Çështjeve Sociale sipas vendimit të Komisionit të Mirëqenjes Sociale, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut? Miratohet projektvendimi për listën e përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike për muajin tetor 2024, me:

9 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

Pika numër 2 e rendit të ditës: Shqyrtimi i projektvendimit për ristrukturimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Fushë-Arrëz, referon, Sekretari i Këshillit, Naze Selimaj në mungesë të përfaqësuesit të zyrës juridike.

Naze Selimaj: Duke iu referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.678 të datës 30.10.2024, “ PËR PËRBËRJEN, RREGULLAT MË TË HOLLËSISHME TË ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KËSHILLAVE VENDORË TË SIGURISË PUBLIKE DHE KËSHILLIT KOMBËTAR PËR SIGURINË NË KOMUNITET”, zyra juridike ka sjellë Projektvendimin të shoqëruar me Relacionin dhe Projektrregulloren përgjritjen e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Fushë-Arrëz, cili është shqyrtuar nga Komisioni Juridik i Mandateve, Rregullores, Zgjedhjeve, Administratës dhe Strukturave Komunitare. Komisioni ka dalë me një relacion ku me shumicë votash është rënë dakord që projektvendimi të kalohet në mbledhjen e sotme të Këshillit Bashkiak.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Këshilli Vendor i Sigurisë Publike është një Këshill i vazhdueshëm, i cili do të ristrukturohet në bazë të Vendimit Nr. 678, datë 30.10.2024 të Këshillit të Ministrave. Ndryshimet nga Këshilli i mëparshëm janë përektuar qartë në vendimin e mësipërm.

Duken si formalizma por ju e dini shumë mirë që situatat emergjente siç ishin reshjet dhe stuhitë e fundit, realisht duhet që në raste të tillë Këshilli Vendor i Sigurisë Publike të jetë fuksional dhe të koordinojnë punën mes institucioneve përkatëse. Ne kemi përparrë një Vendim të Këshillit të Ministrave që thjesht duhet t'a zbatojmë. Ne si Këshill Bashkiak kemi të drejtë në një moment të caktuar të kërkojmë nga Këshilli Vendor i Sigurisë Publike një Raport të punës që ka kryer. Kush është dakord përgjitet e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike dhe përbërjen e tij?

Miratohet projektvendimi përgjitet dhe ristrukturimin e Këshillit Vendor të Sigurisë Publike në Bashkinë Fushë-Arrëz me:

9 vota pro; 0 vota kundër 0 vota abstenim

Pika numër 3 e rendit të ditës: Rishqyrtimi i vendimeve të kthyera nga Prefektura.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Sa i përket Vendimeve të kthyera nga Prefektura përsye të inungesës së dokumentacionit të duhur, do t'i adresohen Kryetarit të Bashkisë dhe zyrate përkatëse të cilat duhet të plotësojnë dokumentacionin brenda kuadrit ligjor.

Kur merret një vendim nga Këshilli, në tre muajt e fundit kërkohet një dokument nga zyra vendore e pasurive të palujtshme të pronave, kërkohet gjendja në tre muajt e fundit për objektin përfundit të cilin bëhet fjalë, sepse ndodh që në tre muajt e fundit mund të ndryshojë pronësia e objektit. Kjo është detyrë e Administratës së Bashkisë.

Pika numër 4 e rendit të ditës: Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave të qytetarëve, institucioneve, etj.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Kemi dy kërkesa pa firmë të personave që e kanë nisë, të cilat zyra juridike i ka konsideruar të parregullta, gjithsesi ne për transparencë po i trajtojmë këto kërkesa ku bëhet fjalë përfundit objekt. Në kërkesën e parë thuhet:

“Unë i nënshkruari Isuf Said Musaj nga fshati Micoj, Pukë, kemi disa prona me letra në Qafën e Sumakullit. Aty kemi tokë, ujë dhe stanet. Këto prona janë mbi 200 vjet me dokumenta. Kemi marrë vesh përfundit të staneve se e keni shitur përbiznes fabrikës Uji Puka. Kërkojmë nga ju të e tërhoqni vendimin se uji është i joni, sepse ne nuk lahem i njëherë në tre muaj në vit por lahem përfundit objekt. Ata që kanë firmosur, nuk kanë pjesë në ujë sepse nuk kanë as tokë e as kullota. Në qoftë se kjo kërkesë bie në vesh të shurdhër do t'i përcjellim letrat për SPAK, në qoftë se nuk zgjidhet në bazë të ligjit, do zgjidhet në bazë të kanunit”.

Kërkesa shoqërohet me 15 emra përfshire edhe emrin e Isufit, ku rezulton se asnjë nga emrat nuk kanë nënshkruar apo firmosur në këtë kërkesë. Kërkesa në fund mban këtë numër telefon 069 21 91 186 dhe firmën e Kryetarit të Bashkisë.

Në kërkesën e dytë thuhet:

"Unë i nënshkruari Ismet Jaho Musaj nga fshati Micoj, Pukë, kemi disa prona me letra në Qafën e Sumakullit. Aty kemi tokë, ujë dhe stanet. Këto prona janë mbi 200 vjet me dokumenta. Kemi marrë vesh për ujin e staneve se e keni shit për biznes fabrikës Uji Puka. Kërkojmë nga jut është të zhvilloni vendimin se uji është i joni, sepse ne nuk lahem i njëherë në trëmuaj në vit por lahem i përditë. Ata që kanë firmosur, nuk kanë pjesë në ujë sepse nuk kanë as tokë e as kullota. Në qoftë se kjo kërkesë bie në vesh të shurdhër do t'i përcjellim letrat për SPAK, në qoftë se nuk zgjidhet në bazë të ligjit, do zgjidhet në bazë të kanunit". Kërkesa shoqërohet me 15 emra përfshire edhe emrin e Isufit, ku rezulton se asnjë nga emrat nuk kanë nënshkruar apo firmosur në këtë kërkesë. Kërkesa në fund mban këtë numër telefon 068 29 40 303.

Këto shkresajtë pa firma dhe pa asnjë lloj nënshkrimi, kjo është një thirrje që çdo gjë duhet të jetë Brenda kornizës ligjore. Kur bëhet fjalë përfond pyjor, është drejtoria e pyjeve që menaxhon dokumentacionin.

Hil Curri, Krytar i Bashkisë:

Kërkesa nuk ka lidhje me ne, personi na kërkon neve të jepim llogari se çfarë bëhet me një burim uji që nuk është në territorin tonë por është në territorin e Bashkisë Pukë. Pra burimi dhe toka ku është burimi janë në pronësinë e Bashkisë Pukë. Burimi, toka dhe 60% e kanalit janë në territorin e bashkisë Pukë.

Në territorin e bashkisë tonë kalon vetëm një pjesë kanali me tubat përcjellës i cili në pjesën më të madhe të gjatësisë së tij shkon përfundimisht në makinës.

Besjana Marku, këshilltare: Mos ka dashur të e nisë përfundimisht këtë person e gabimisht ka ardhur tek ne?

Nikolin Bardboku, Krytar i Këshillit Bashkiak: Ne përfundimisht do t'ë trajtojmë çdo kërkesë apo unkesë të personave që i drejtohen Këshillit Bashkiak. Meqë jemi drejtës përdrejt në transmetim live gjej rastin të shpërgoj publikun se çdo vendim merret nga Këshilli Bashkiak e jo nga Kryetari i Këshillit, në rastin konkret ne nuk kemi marrë vendim përfundimisht për burim uji por për kanalin ku transportohet uji. Ne jemi të hapur, nëse dikush pretendon se një vendim në Këshillin Bashkiak është marrë mënyrë të padrejtë, personi i drejtuhet gjykates.

Tek ne është sjellë një projekt nga Drejtoria e Pyjeve, jemi shprehur me një vendim përdorim të dhënës të një sipërsaqeje toke shtet përfundimisht.

Ne nuk mund të pengojmë njerëzit që t'ë bëjnë investime nëse ato janë konform ligjit. Njëjtë është sikur ne t'ë kundërshtojmë apo t'ë pengojmë investitorët pa u bazuar në ligj, kjo nuk mund t'ë ndodhë, sepse në t'ë kunët i bie t'ë pengojmë zhvillimin e vendit.

Pika numër 5 e rendit të ditës: Të ndryshme

Vjolcea Tabakaj, këshilltare: Çfarë masash ka marrë Bashkia përfundimisht e rrugëve së Iballës mbas reshjeve e stuhisë së fundit? Rrugët janë copë-copë.

Hil Curri, Krytar i Bashkisë: Situatia është në gjendje shumë të rëndë, kam dërguar projektin e rrugës së Iballës, Ministri na ka thënë po, drejtori po, presim tanë. Besoj do kemi shpejt një mjet që do t'ë na mundësojë t'ë kryejmë riparimet e nevojshme.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Kryetar, a ka një fond rezervë për rastet e emergjencave civile? Fokusi i Këshillit të Bashkisë është te punët publike.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë: E kemi fondin por e ka bllokuar thesari. Nga fondi rezervë i Bashkisë Fushë-Arrëz dhe fondi i emergjencave civile nuk është prek asnjë lek. Pengesa përkëtë vit është thesari.

Besjana Marku, këshilltare: Një situatë e tillë e rënduar mbas reshjeve është edhe në shkollën ku punoj unë. Në shkollën Dardhë 50% e çatisë është dëmtuar nga reshjet e shiu të fundit në shkollë dhe qdo material që është punuar të Enjten përfestat e Nënitorit e kemi gjetë në tokë të Hënën kur kemi shkuar.

Hil Curri, Kryetar i Bashkisë: Shiu i ditëve të fundit ka bërë dëmtime të shumta, qdo gjë do të identifikohet, do të ndërhyjmë dhe do bëjmë thirrje ndonjë operatori apo biznesi të na ndihmojë qoftë edhe në mënyrë humanitare, nuk mund të lëmë rrugët e bllokuara.

Nikolin Bardhoku, Kryetar i Këshillit Bashkiak: Nëse nuk ka kush ndonjë gjë tjeter, mbledhjen e deklaroj të myllur.

Procesverbali mylllet me numër të faqes 5.

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

Besjana Marku

Bavollika Qafa

FRANC DODA

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU



Valentina Lleshaj